



# fletëgarancie

(MODEL TIP I FLETËGARANCISË)

Data: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

**Tirana Teknologji, sh.p.k.**, garanton cilësinë e materialeve të saj të përdorura në instalime dhe është e detyruar, të zëvendësojë ose riparojë, çdo material defektoz që ka për **origjinë fabrikimin**.

Për këtë qëllim duhet të përmbushen këto kushte:

1. Garancia nuk nënkupton në asnjë mënyrë ndërrimin e pajisjes, por riparimin ose ndërrimin e pjesës së dëmtuar.
2. Riparimi i defekteve dhe servisi në aparat, brenda periudhës së garancisë, janë e drejtë ekskluzive e Tirana Teknologji, sh.p.k.
3. Shërbimi periodik i pajisjeve gjatë periudhës së garancisë duhet të bëhet vetëm nga persona të autorizuar prej Tirana Teknologji, sh.p.k.
4. Shërbimi periodik dhe materialet e përdorura për këtë qëllim, shkojnë për llogari të përdoruesit. Ky shërbim kushton (shih kontraten bashkëngjitur) të vlerës së preventivit.
5. Shërbimi periodik mujor i pastrimit të filtrave është detyrë e përdoruesit përjashtuar këtu rastin kur përdoruesi shpreh dëshirën që këtë shërbim ta kryejë Tirana Teknologji, sh.p.k.
6. Tirana Teknologji, sh.p.k. nuk mban garanci në rast se pajisjet nuk mbrohen me salvamotor.
7. Tirana Teknologji, sh.p.k. nuk mban garanci në rast se sistemet e përdorura për funksionimin e pajisjeve (sistemi elektrik, sistemi i kondensatit, sistemi i fryrjes, sistemi i ajrit të freskët, etj) manipulohen ose përdoren për qëllime të tjera.
8. Tirana Teknologji, sh.p.k., nuk mban përgjegjësi për defekte të shkaktuara nga pakujdesia, keqpërdorimi si dhe luhatjet e tensionit.
9. Rrjeti i përdorur për lëshimin e motorit duhet të përmajë lëshues, rrele termike dhe të jetë i tokëzuar dhe të ketë parametrat e përcaktuara në tabelën e pajisjes.
10. Garancia për elektromotorrët shtrihet në 12 muaj.
11. Garancia fillon nga dita e firmosjes së kësaj Fletëgarancie.
12. Kjo Fletëgaranci është e vlefshme kur është e firmosur dhe vulosur nga të treja palët.
13. Kjo Fletëgarancie ka 1(një) faqe dhe është bërë në tre kopie.

**Tirana Teknologji , sh.p.k.**

**Instaluesi**

**Përdoruesi**